

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Automjete me qira operationale leasing”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

60182000-07 – Marrje me qira e automjeteve industriale me shofer.

VLERA E FONDIT LIMIT:

35,500,000 (tridhjetë e pesë milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “**Operatori i Sistemit të Transmetimit**” (OST) sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 35,000,000 (tridhjetë e pesë milion) Leke.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe cilësinë e mallrave objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlere e xhiros te jete ne masen 20,000,000 (njezet milion) Leke.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 14,000,000 (katermbedhjetë milion) Lekë pa TVSH.

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vertetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlere, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 33 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e mallrave dhe shërbimet objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar për automjetet që do të merren me qira objekt prokurimi. Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën perkatese të vlefshme të ISO-ve, (të perkthyer në shqip dhe të noterizuar) të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:*

- *ISO 9001: për Sistemin e Menaxhimit të Cilesisë, objekti i se ciles te kete lidhje me objektin e prokurimit.*

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në bazë të Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., datë 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur

aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Standarti i cilesise ISO 9001: është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësive të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë permasave. Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Në lidhje me kërkesën që OE ofertues të paraqesë licencën e sipërcituar është menduar si i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, me qëllim për të siguruar AK që mallrat e ofruar do të jenë cilësorë dhe me parametra që plotësohen nga prodhues të licencuar sipas standardeve ndërkombëtare të cilësisë. Plotesimi i këtyre kriterëve nga ofertuesit e interesuar, garanton realizimin me sukses dhe me cilësi të objektit të kontratës.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit për automjetet që do të merren me qira objekt prokurimi. Në katalog, të markohet në mënyrë të qartë dhe të dallueshme artikulli që oferton sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të produktit që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të vlerësojë nëse produkti i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*

Argumentimi: Ky kriter është menduar për të dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me pikën 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë dhe të paraqesë licencë të lëshuar nga QKB, me kodin si vijon:*

- VII.3.B.2 – “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura të autorizuar nga prodhuesi”.

Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e pikës 4/a të nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në lidhje me licencën profesionale të OE ofertues.

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të specifikojë se:*

- ✓ *Pranon dhe merr përsipër çdo shpenzim të automjetit dhe garanton se gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës (60 muaj) do të jetë i rregullt për qarkullim, përse i përket anës teknike të mjetit dhe dokumentacionit të nevojshëm, sipas legjislacionit në fuqi.*

- ✓ *Automjeti objekt procedure prokurimi eshte i ri dhe i paperdorur me pare.*
- ✓ *Garanton ne cdo moment furnizimin me nje automjet ne gjendje pune, ekuivalent me ate te marre me qira objekt procedure prokurimi, ne rastin kur ky i fundit ka nje defekt ose eshte i paperdorshem per shkak te sherbimeve periodike te detyrueshme.*
- ✓ *Automjetet objekt procedure prokurimi do te jene ne cdo moment te gatshme per t'u perdorur ne rruge, sipas nevojave te AK, te pajisura me dokumentacionin e rregullt, sipas dispozitave ligjore ne fuqi, gjate te gjithe periudhes se zbatimit te kontrates.*

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të ketë garanci që ofertuesi do të paraqesë mallrat objekt kontrate në cilësinë e kërkuar nga AK, është vendosur në përputhje me piken 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Gjithashtu edhe që AK të ketë sigurinë se OE ofertues merr përsiper detyrimet e tij për zbatimin e kontrates.

2.3.7 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 9 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.*

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.